

# Aksion pastrimi dhe ndërgjegjësimi për mbrojtjen e mjedisit.

Përshëndetje nga Korça të dashur vëllezër dhe motra!

Në kuadrin e projekteve që çdo anëtar I STF-it duhet të bëjë, më datë **06.07.2012** u organizua projekti mbi sensibilizimin e qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit. Një nga gjërat që të bën përshtypje në Shqipëri është ndotja. Prandaj u vendos që ky projekt të kishte qëllim ndërgjegjësimin e banorëve të Korçës për mbajtjen pastër të qytetit. Tema e projektit ishte “ Bëj Revolucion”.


Projekti nisi me një prezantim se pse është e rëndësishme mbajtja pastër e mjedisit. U theksua se ç'do kush prej nesh është pronar i mjedisit që na rrethon dhe si të tillë duhet të kujdesemi për të ashtu si kujdesemi për diçka që ka shumë vlerë për ne.

Pjesëmarrës ishin anëtarë dhe të ftuar të rinj.

Sfida e parë ishte ndërgjegjësimi i drejtëpërdrejtë I banorëve. Ç'do grup duhet të mblidhte sa më shumë firma nga qytetarët të cilët përpara se të firmosnin duhet të zotoheshin se nuk do të hedhin asnjë mbeturinë në tokë. Të gjithë grupet ishin shumë të frymëzuar dhe kjo dukej shumë qartë pasi ata vraponin për të mbledhur sa më shumë firma.



Sfida e dytë ishte pastrimi i nje zone të ndotur të qytetit. Grupi që do të mbushte më shumë qese me mbeturina do të ishte fitues i kësaj sfide



Ky projekt ishte i suksesshem pasi u mblodhën më shumë se 300 firma çka do të thote se 300 banorë të qytetit do të mendohen dy herë para se të hedhin një mbeturinë në tokë. Gjithashtu u pastrua një zonë shumë e ndotur e qytetit.

